VENDIM
Nr.686, datë 2.6.2010

PËR KRIJIMIN E ORGANIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT TË AKSIDENTEVE/INCIDENTEVE AJRORE NË AVIACIONIN CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 93 të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, si një institucion juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për transportet, me seli në Tiranë. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore ka vulën dhe stemën e vet zyrtare.

2. Objekti i veprimtarisë së Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore është investigimi i plotë i çdo aksidenti/incidenti ajror, në zbatim të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", nëpërmjet kryerjes së shpejtë të procesit të investigimit dhe nxjerrjes së shkaqeve të aksidenteve/incidenteve ajrore.

3. Kriteret dhe procedurat, sipas të cilave Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore kryen funksionet dhe organizon procesin e investigimit, janë të përcaktuara në rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e investigimit të aksidenteve/incidenteve në aviacionin civil", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, për veprimtarinë e tij, i raporton ministrit përgjegjës për transportin. Organi i paraqet ministrit, në çdo kohë, me kërkesë të tij, çdo të dhënë ose informacion në lidhje me veprimtarinë e tij.

5. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, për të realizuar detyrat, përgjegjësitë dhe objektivat e përcaktuar në këtë vendim, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me institucionet e ndryshme të vendit, publike dhe/ose private, grupet e interesit, vendase dhe/ose të huaja.

6. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon me:

- Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO);
- Struktura të ngjashme të vendeve anëtare të Zonës së Përbashkët të Aviacionit Evropian (ZPAE), si dhe të vendeve të ndryshme të rajonit dhe të botës;
- Institucionet jofitimprurëse e donatorë të ndryshëm, vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

7. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore është institucion buxhetor dhe financohet nga Buxheti i Shtetit. Këshilli i Ministrave akordon fondet përkatëse, të mjaftueshme, për të realizuar procesin e plotë të investigimit, në rastin e ngjarjeve të caktuara.

8. Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore drejtohet nga kryetari dhe ka në përbërje gjashtë inspektorë. Kryetari është titullari i institucionit dhe përfaqëson Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore, në marrëdhënie me të tretët. Struktura dhe organika e tij miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

9. Për emërimin e kryetarit dhe të inspektorëve të Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore duhet të plotësohen kërkesat dhe kriteret e mëposhtme:

a) Të kenë shtetësi shqiptare;

b) Të kenë arsim të lartë;

c) Të jenë persona me përvojë profesionale, me aftësi teknike dhe menaxheriale, për çështje që kanë të bëjnë me sektorin e hapësirës ajrore dhe me sigurinë në fluturim;

ç) Të jenë me integritet moral dhe profesional;

d) Të jenë të paangazhuar në funksione drejtuese partiake;

dh) Të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;

e) Të mos jenë të përjashtuar nga shërbimi civil;

ë) Të mos kenë konflikt interesash me detyrën në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

10. Kryetari dhe inspektorët e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në aviacion emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për transportin, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

Mandati i kryetarit është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

11. Organi Kombëtar për Investigimin e Aksidenteve/Incidenteve Ajrore ka, të paktën, një investigues të aftë për të kryer funksionin e investiguesit në detyrë, në rastin e një aksidenti apo incidenti të rëndë në aviacion, i cili duhet të jetë i kualifikuar dhe me përvojë pune në aviacion, sipas përcaktimeve në rregulloren bashkëlidhur.

12. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore rregullohen me Kodin e Punës. Niveli i pagave të punonjësve të tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Efektet financiare, sipas zërave "Fond page", në vlerën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, "Sigurime shoqërore", në vlerën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, "Shpenzime operative", në vlerën 2 000 000 (dy milionë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Numri i punonjësve prej 9 (nëntë) vetash përfshihet në numrin e përgjithshëm të punonjësve, të miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për vitin 2010.

14. Vendimi nr.48, datë 28.1.1999 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bordit të hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore në aviacionin civil", shfuqizohet.

15. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha